

**S T A T U T I**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE**  
**ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Albanian Night” SH.P.K.**

Sot, më datë 05.12.2023, Ortakët Armando MUÇA dhe Erisa SULA bazuar në vullnetin e tyre të lirë themeluan shoqerinë “Albanian Night” SH.P.K., në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare”, i ndryshuar dhe vendosen të hartojnë këtë statut për funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Albanian Night” SH.P.K.

**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1**  
**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 05.12.2023 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “Albanian Night” SH.P.K.

Themeluesit e shoqërisë jane:

**Z.Armando MUÇA**, i biri i Agronit, i datëlindjes 08.08.1989, mbajtës i dokumentit të identitetit me numër 033178645 dhe Numër Personal I90808057L, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Njësia Administrative Nr.1, Rr.“Dh.Kamarda”, Ndërtesa Nr.31/1, Kodi postar 1004.

**Znj. Erisa SULA**, e bija e Dilaverit, e dtl. 15.09.1983, mbajtëse e dokumentit të identitetit me numër 038051363 dhe Numer personal I35915002D, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, Njësia Administrative Nr.2, Rr.“Tefta Tashko Koço”, Pasuria Nr.5/640+2-36, Ndërtesa Nr.41, H.2, Apartamenti 36, Kodi postar 1017.

**Neni 2**  
**Selia**

Selia juridike e Shoqërisë, ndodhet në Tiranë, Njësia Administrative Nr. 7, Rr. e Kavajës, Zona Kadastrale 8250, Pasuria Nr.2/827+1-31, Sh.1, Apartameni Nr.31.

Shoqëria me miratimin e organeve kompetente, mund të krijojë qëndra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj per një periudhe kohore te papercaktuar.



## **Neni 4 Objekti**

Shoqëria do te kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Aktivitete rekreative dhe turistike brenda hapsirës tonë në lidhje me vallet, kostumet popullore dhe muzikë tradicionale shqiptare. Aktivitete me ushqim për klientët që marrin pjesë në eksperiencën Albanian Night, ku nëpërmjet partnerëve të tretë do të ofrojmë ushqim për të ngrënë.

Blerja, shitja dhe dhënia me qera e kostumeve popullore shqiptar.

Ofrim seti fotografik kundrejt pagesës.

Shitja e pijeve alkoolike, freskuese dhe të tjera pije të prodhua brenda vendit.

Shfaqe muzikore dhe të tjera aktivitete me trupe artistësh që performojnë.

Dhënie hapësire multifunksionale për qera ditore, si dhe organizime eventesh të ndryshme, të karaktereve të ndryshme me tematikë kulturën shqiptare, por jo vetëm. Organizime prezantimesh, eventesh promovimesh të cfarëdolloj natyre që janë në sintoni me filozofinë e biznesit tonë.

Prezantimi dhe ekspozimi i punimeve artizanale shqiptare me qëllim promovimin e produkteve artizanale. Blerja e produkteve artizanale të prodhua në Shqipëri me qëllim rishiten e tyre.

Shoqëria mund të kryeje cdo operacion tregtar, si edhe të blejë dhe të shesë ose të marrë me qera ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si dhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, të themeluara apo ne themelim e sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngashëm më të vetin, apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.

Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera, të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **KREU II KAPITALI**

### **Neni 5 Kapitali themeltar**

Kapitali fillestar i shoqërisë është 2 000 000 (dy milionë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre, si më poshtë:


Ortakët themelues janë:

**Z. Armando MUÇA**, është zotëruar i 1(një) kuote të kapitalit, me vlerë 1 500 000 (një milion e pesëqindmijë) lekë, që përbën 75 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**Znj. Erisa SULA**, është zotëruar e 1(një) kuote të kapitalit, me vlerë 500 000 (pesëqindmijë) lekë, që përbën 25 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### **Neni 6 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpermjet emërimit të një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.



Nëe asnjë rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nga Asambleja e Ortakëve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### **Neni 7 Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve perderisa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8 Organi Vendimarrës**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte përgjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e statutit
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te ketij nenii
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje



ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaquesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### Neni 9

#### Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet me shkrese ose mesazh elektronik, duhet te permboje vendin, daten, oren e mbledhjes, rendin e dites dhe t'u dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se para 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur, asambleja e per gjithshme e ortakeve nuk eshte thirrur sipas kesaj menyre, ajo mund te marre njoftime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsisse.

#### Neni 10

#### Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme e ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejt vote, qe zoterojne me shume se 30% te kuotave. Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshtje , te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 Te Ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysma e numrit total te votave jane te pranishem personalisht , votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te Nenit 88 te ligjt super mendur.

Nese asambleja e per gjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite

#### Neni 11

#### Marrja e Vendimeve

Asambleja e per gjithshme e Ortakeve, vendos me tre te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e per gjithshme e ortakeve vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtje te tjera, si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shperblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

**Neni 12**  
**Përjashtimi nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqeshet nga nj i perfaqesuar i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njetin konflikt interes, ashtu sic eshte dhe ortaku, te cilin perfaqeson.


**Neni 13**  
**Administrimi**

Administrator i shoqërisë emërohet:

**Znj. Erisa SULA**, e bija e Dilaverit, e dtl. 15.09.1983, mbajtëse e dokumentit të identitetit me numër 038051363 dhe Numer personal I35915002D, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, Njësia Administrative Nr.2, Rr.“Tefta Tashko Koço”, Pasuria Nr.5/640+2-36, Ndërtesa Nr.41, H.2, Apartamenti 36, Kodi postar 1017.

**Znj. Erisa SULA**, emërohet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare, me të drejtë ripërtëritje.

**Emer Mbiemer**



**Nënshkrimi**



Administratori i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakerisë.

**Neni 14**  
**Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë e detyrohet:

- a) te kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e pergjithshme ;
- b) te përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) te kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) te përgatisin dhe nënshkruejë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) te krijoje një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e) te kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- f) te raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;



g) te kryjene detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratori ka të drejtë të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqerinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Nese Asambleja e Pergjithshme emeron me shume se një administrator, ata e administrojnë bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin e shoqerise ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

### **Neni 15** **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Pergjitheshme e Ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te percaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mëjdis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të percaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per

Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

## **KREU IV VITI FINANCIAR- EKSPERTËT**

### **Neni 16 Viti Financiar**

Viti finansiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finansiar, fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit finansiar, Asambleja e Pëergjithshme e Ortakëve, miraton Llogarite vjetore të paraqitura nga Administratori, vendos për krijimin e fondit rezerve, fondeve për investime, si dhe destinime të tjera të fitimit ose humbjes së vitit ushtrimor.

### **Neni 17 Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimitarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille. i ngarkuar nga ana e ortakeve

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtaur e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **KREU V PRISHJA – RIORGANIZMI I SHOQËRISË**

### **Neni 18 Prishja dhe likujdimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne edo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakëve
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij



emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".  
Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.  
Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.  
Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizimi i shoqerisë: Baskimi- Ndarja**

Shoqëria mund te ndahet , bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se pergjithshme te Asamblese se Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2012 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.  
Për sa nuk parashikohet në ketë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKËT  
E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Albanian Night":**

Armando MUÇA Erisa SULA

Armando Muça Erisa Sula  
AMZ ES